

VENDIM
Nr.689, datë 22.10.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.601, DATË 2.11.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FUNKSIONET NË MINISTRINË E RENDIT PUBLIK, QË KANË TË
DREJTËN E MBAJTJES SË GRADËS SË POLICISË SË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.601, datë 2.11.2001 të Këshillit të Ministrave, pas emërimit “...Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm...” të shtohet emërtimi “...të sektorit të shifrës...”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano